



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

*Komisioni Posaçëm për Reformën Zgjedhore*

**PROCESVERBAL**

Tiranë, më 10.11.2017, ora 11:00

**Drejton mbledhjen:**

**Gramoz Ruçi – Kryetar i Komisionit**

**Rendi i ditës:**

Konstituimi i Komisionit të Posaçëm për Reformën Zgjedhore

**Marrin pjesë:**

Bledar Çuçi, Oerd Bylykbashi, Vasilika Hysi, Ermonela Felaj, Alket Hyseni, Adnor Shameti, Klotilda Bushka, Blerina Gjylameti, Musa Ulqini, Gent Strazimiri, Nasip Naço, Luan Rama, Nard Ndoka, Dashamir Shehi dhe Fatmir Mediu.

**Mungojnë:**

Bashkim Fino, Vangjel Dule dhe Enkelejd Alibeaj.

## HAPET MBLEDHJA

**Gramoz Ruçi** - Të nderuar anëtarë të Komisionit të Posaçëm Parlamentar për Reformën Zgjedhore,

I nderuari Ambasador i OSBE-së,

Të nderuar përfaqësues të Këshillit të Europës dhe të delegacionit europian,

Është kënaqësi për mua, si Kryetar i Kuvendit, që marr pjesë në këtë mbledhje të parë të konstituimit të Komisionit të Posaçëm Parlamentar për Reformën Zgjedhore.

Siç e dini, Kuvendi, me vendimin nr. 102/2017, ka ngritur Komisionin e Posaçëm Parlamentar për Reformën Zgjedhore. Sipas këtij vendimi, komisioni ka për detyrë hartimin e ndryshimeve të Kodit Zgjedhor, trajtimin e rekomandimeve të raporteve të OSBE-ODIHR-it për zgjedhjet e fundit, duke filluar me 2013-ën, 2015-ën dhe 2017-ën, jo vetëm këto, por edhe të institucioneve përgjegjëse për zgjedhjet, mbi të gjitha, por edhe të propozimeve të partive politike që kanë marrë jo më pak se 1% të votave të zgjedhësve në zgjedhjet e fundit politike.

Të gjithë jeni të ndërgjegjshëm për rëndësinë e madhe që ka standardi i zgjedhjeve, për cilësinë e demokracisë në vendin tonë, aq më tepër që tashmë vendi ynë është një vend kandidat për anëtar të BE-së, me qëllimin e qartë për të hapur sa më shpejt të jetë e mundur negociatat për anëtarësim. Prandaj, puna e këtij komisioni, edhe në këtë kuadër, ka një rëndësi vendimtare.

Është risi fakti që ky komision ngrihet që në fillim të legjislaturës, pra për përmirësimin e kuadrit ligjor zgjedhor, i cili duhet t'i paraqitet në kohën e duhur Kuvendit për miratim, me qëllim që t'i paraprijnë përgatitjes, siç duhet, edhe institucionet përkatëse zgjedhore për zgjedhjet e ardhshme, qofshin ato vendore apo të përgjithshme. Sigurisht, komisioni, sipas vendimit, do të mbështetet jo vetëm në rekomandimet e OSBE-ODIHR-it, por edhe në praktikën më të mira parlamentare për të përgatitur ndryshimet e duhura në legjislacionin zgjedhor me standardet më të larta.

Zgjedhjet dhe reformat zgjedhore kërkojnë, sigurisht, vullnet politik, që do të thotë konsensus. Kjo gjë tashmë ka filluar. Është shumë pozitive që ky komision u ngrit në mënyrë konsensuale, e kërkuar nga opozita.

Unë uroj që në vazhdim të punës suaj, pikërisht këtë frymë bashkëpunimi, mirëkuptimi, vullneti politik dhe konsensusi ta ruani në të gjithë punën dhe veprimtarinë tuaj.

Në zbatim të pikës 11 të vendimit nr. 102/2017 unë, si Kryetar i Kuvendit, dhe sekretari i Përgjithshëm, tashmë kemi krijuar të gjithë mbështetjen nga burimet njerëzore, financiare, logjistike për një veprimtari normale të komisionit dhe të grupit të ekspertëve të

ngritur pranë këtij komisioni. Kështu, me urdhrin nr. 230, datë 23.10.2017, sekretari i Përgjithshëm ka ngritur sekretarinë teknike, që do të asistojë në të gjithë veprimtarinë e këtij komisioni, si dhe janë caktuar mjediset e punës për grupin e ekspertëve.

Meqenëse kjo është mbledhja e parë, me rastin e fillimit të punës së këtij komisioni, dëshiroj të ftoj të dy bashkëkryetarët që të japin mesazhin e tyre për fillimin e punës së këtij komisioni.

Fjala është për ju, zoti Oerd.

**Oerd Bylykbashi** – I nderuar zoti Kryetar,

Të nderuar kolegë të komisionit,

Të nderuar Shkëlqesi ambasadorë,

Më në fund po fillojmë reformën zgjedhore. Po them “më në fund”, sepse është për të ardhur keq që ne sot jemi këtu për të trajtuar tri raporte të OSBE-ODIHR-it, raportet e viteve 2013, 2015 dhe 2017. Është e paprecedentë, e papranueshme dhe, sigurisht, aspak në nderin e këtij Kuvendi që, në një legjislaturë të plotë, nuk bëri gjë tjetër veçse shkeli angazhimet ndërkombëtare të Shqipërisë, karshi OSBE-së dhe Këshillit të Europës, për të trajtuar rekomandimet menjëherë. Ky është një angazhim konkret, i shkruar i Shqipërisë, të cilin në një dekadë Kuvendi i Shqipërisë e ka respektuar, por në 5 vjetët e fundit ky parlament, kjo maxhorancë ka dështuar me sukses ta bëjë këtë gjë.

Fakti që ne jemi mbledhur kaq shpejt në këtë komision, të thirrur nga opozita, që në hapje të sesionit, vjen edhe për një gjë shumë të thjeshtë: mblidhet për herë të parë, që nga viti 2001, për një rekomandim. Nuk është në nderin e këtij parlamenti, aq më tepër nuk është në nderin e maxhorancës, që, për herë të parë, që nga viti 2001, OSBE-ODIHR-i shkruan një rekomandim, si prioriteti i parë, ku kërkon ngritjen e Komisionit të Reformës Zgjedhore, sepse më parë nuk ka qenë i nevojshëm. Është e qartë që vullnetin politik, siç e tha dikur në vitin 2001, nuk e zëvendëson dot shkrimi i ligjeve. Vullneti politik është themeli. Pra, ose është vullneti dhe bëhet reforma, ose nuk është vullneti dhe nuk bëhet reforma. Vullneti nuk ishte, ndaj reforma nuk u bë, sepse qëllimi ishte që të fitoheshin zgjedhjet.

Rekomandimet e para prioritare të këtij raporti, që janë të paprecedente për Shqipërinë, tregojnë se si janë fituar zgjedhjet dhe cili është legjitimiteti i këtij parlamenti. Nuk është “Përpyetje joserioze”, siç është në versionin shqip, por “Përpyetje të forta për të luftuar shitblerjen e votës”. Kjo nuk është thënë kurrë, të paktën jo në rekomandimin e parë. Në vitin 2015 është hera e parë që rekomandimi prioritar dhe më i rëndësishmi, që kanë raportet e OSBE-ODIHR-it, është të luftohet shitblerja e votës, sepse e ka me fakte dhe faktet

vazhdojnë të dalin se si zgjedhjet janë blerë me paratë e krimit, me paratë e korrupsionit dhe me paratë e drogës.

Përdorimi abuziv dhe i paprecedentë i shtetit për të ushtruar presion mbi zgjedhësit, në sinergji të plotë me bandat, është ajo që e ka detyruar raportin e OSBE-ODIHR-it të nxjerrë këtë set rekomandimesh, ku të gjitha rekomandimet e para kanë të bëjnë me shkelje themelore të zgjedhësve. Standardet nuk janë fraza të shkruara në letër, por janë ato që bëjmë çdo ditë. Maxhoranca, në këta 5 vjet, në këto zgjedhje ka bërë atë që dihet nga të gjithë shqiptarët. Ky është një parlament, që ka legjitimitetin e tij dhe një kjo është një maxhorancë që ka legjitimitetin e saj mbi shitblerjen e votës, mbi krimin zgjedhor, mbi korrupsionin zgjedhor, mbi përdorimin kriminal për të bërë presione (këtë e thotë OSBE-ODIHR-i, nuk e them unë) mbi zgjedhësit në administratën publike apo në vendin privat të punës, jashtë qendrës së votimit apo deri te dhoma e fshehtë (këtë e thotë OSBE-ODIHR-i, nuk e them unë) janë ato që kanë prodhuar deformimin e këtij rezultati. Kjo është ajo që bëri diferencën, është ajo që i dha kësaj maxhorance mundësinë që të ushtrojë pushtetin sot në mënyrë arrogante, atë pushtet që ne e dimë shumë mirë se çfarë po diskutojmë. Maxhoranca përdori imunitetin për të mbrojtur veten. Të gjitha këto janë të papranueshme.

Ne sot jemi këtu së bashku sepse, nëse nuk rregullohen standardet e zgjedhjeve, shqiptarët nuk kanë asnjë lloj hapësire që të kenë një qeveri legjitime. Sigurisht, çdo gjë që ne do të bëjmë këtu, nëse nuk luftohet krimi i organizuar, jashtë këtij parlamenti, ai që e ka simbiozën sot me qeverinë, çdo gjë që do të shkruajmë ne nuk do të ketë efekt, sepse ato shkojnë dorë për dorë. Por le të mos krijojmë asnjë iluzion, sepse sot nuk është një histori konsensusi. Sot jemi ulur këtu, sepse juve ju detyron një raport i hidhur i OSBE-ODIHR-it dhe i Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Europës, i cili është i paprecedentë që nga viti 2001 dhe e keni detyrim.

Ne sot kërkojmë atë që kërkon çdo opozitë, standardet e zgjedhjeve, të luftohet shitblerja e votës, të luftohet krimi zgjedhor, që nuk e bëjmë ne. Ju keni detyrimin t'i qëndroni kësaj loje, sepse ju detyron raporti i OSBE-ODIHR-it dhe raporti i Këshillit të Europës. Se çfarë do të bëni rrugës ajo mbetet për t'u parë, por ne jemi këtu për t'i qëndruar deri në fund kësaj dhe, sigurisht, prioriteti, për të luftuar pjesën dërrmuese të këtyre çështjeve, është votimi elektronik. Po e fillojmë sot këtë rrugë në mënyrë që nesër të mos thonë se nuk kishte kohë. Pra, do të kemi kohë që të diskutojmë, të debatojmë, të marrim ekspertizën më të mirë, të gjejmë paratë që kjo gjë të bëhet, në mënyrë që të mos prenotohen 6 muaj para kartat e identitetit të qytetarëve, apo t'u merren qytetarëve që të mos votojnë ditën e votimit; që të mos blihet vota nëpërmjet kësaj; që të mos korruptohen komisionerët zgjedhor dhe të mos

manipulohet votimi. Pra, një sistem votimi elektronik, që do të garantojë identifikimin biometrik, votimin elektronik dhe numërimin elektronik, përtej duarve të 40 mijë komisionerëve politikë. Kjo duhet të jetë kryefjala për të zgjidhur të gjitha problemet e tjera, përfshirë çështjet e tjera të rëndësishme, siç janë: financimi i zgjedhjeve, listat e zgjedhësve, votimi i emigrantëve, i cili nuk do të jetë kurrë i suksesshëm në qoftë se nuk luftojmë dhe i ngremë standardet e zgjedhjeve sot këtu në Shqipëri, sepse çdo votim me postë apo në ambasada është qesharak edhe i bie që të tallemi me shqiptarët nëse ua ofrojmë këtë gjë.

Theksoj: themeli i këtij parlamenti është në ilegjitimitet të plotë, është i bazuar në vullnetin e parasë së drogës dhe të kimit dhe jo në vullnetin e zgjedhësve. Ne këtu kemi detyrë që ta kthejmë këtë mbrapsht, sigurisht që ju keni detyrimin t'i qëndroni reformës zgjedhore dhe të mbetet në nderin e parlamentit shqiptar që të trajtojë probleme reale të këtyre zgjedhjeve, duke përfshirë të gjitha rekomandimet e OSBE-ODIHR-it.

Faleminderit!

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

**Gramoz Ruçi** – Jo, do të flasim vetëm bashkëkryetarët, sepse nuk kemi mbledhje komisioni sot!

**Bledar Çuçi** – Faleminderit, zoti Kryetar!

Të nderuar kolegë,

Të nderuar të ftuar,

Shkëlqesi ambasadorë,

Shqiptarët folën qartë më 25 qershor, ku dëshironin që edhe për 4 vjet të qeveriseshin qartazi nga Partia Socialiste. Gjithashtu, edhe ndërkombëtarët folën qartë para dhe pas 25 qershorit. Ata folën qartë para 25 qershorit kur vlerësuan me nota maksimale marrëveshjen e arritur midis maxhorancës dhe opozitës. Në një rast të paprecedentë në historinë politike shqiptare, maxhoranca i ofroi, para zgjedhjeve, opozitës gjysmën e qeverisë, atë gjysmë që lidhet drejtpërdrejtë me administrimin e zgjedhjeve, si dhe i dha kryetarin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Më shumë se kaq, sigurisht, ne nuk mund të bënim, sepse i binte vetëm që t'ia dorëzonim qeverisjen në letër, gjë që besoj se, edhe për kolegët e opozitës, tingëllon shumë absurde.

Partia Socialiste, maxhoranca, që është në qeverisje, sigurisht që këtë vullnet të shqiptarëve e lexon me shumë përgjegjshmëri. Me të njëjtën përgjegjësi ne ngritëm edhe Komisionin për Reformën Zgjedhore, për të vlerësuar rekomandimet e OSBE-ODIHR-it të viteve 2013-2015, ku, fatkeqësisht, ishte opozita ajo që e bojkotoi, pasi u zhvendos nga mjediset e parlamentit në çadër, në mes të bulevardit. Pa diskutim që në komisionin e ri, që,

fatmirësisht, po e ngremë dhe po fillojmë punën në fillimin e legjislaturës, duke na lënë kohë për të marrë vendimet e duhura qoftë për zgjedhjet vendore, qoftë për zgjedhjet e ardhshme parlamentare, ne do të adresojmë edhe detyrimet e mbetura nga rekomandimet e OSBE-ODIHR-it për zgjedhjet e viteve 2013- 2015.

Në rekomandimet e vitit 2015 të OSBE-ODIHR-it, pa diskutim që partnerët tanë kanë folur qartë kur kanë thënë se ishin zgjedhjet më të qeta të mbajtura ndonjëherë në Shqipërinë postkomuniste dhe, pavarësisht nga problemet e shumta që kishte, ato nuk e cenon kursesi legjitimitetin e maxhorancës së dalë nga këto zgjedhje. Më qartë se kaq unë nuk besoj se kanë folur ndonjëherë.

Të nderuar kolegë të opozitës, pa diskutim që, si unë, edhe Partia Socialiste, jemi të shqetësuar për faktin se rekomandimi që ka shoqëruar në gjithë këta vjet raportin e OSBE-ODIHR-it për zgjedhjet në Shqipëri, e cila lidhet me blerjen e votës, ka kaluar në rend më prioritar se rekomandimet e kaluara. Pa diskutim që jemi të shqetësuar, por besoj se nuk është vendi këtu që t'ju kujtoj se po në këtë raport të OSBE-ODIHR-it ju e dini shumë mirë se i vetmi ilustrim në këtë raport, që lidhet me blerjen e votës, vjen nga opozita. Ilustrimet për abuzimin e administratës publike vijnë nga të dyja forcat, qoftë që nga qeveria, qoftë nga opozita, aty ku është në qeverisje vendore, qoftë edhe nga maxhoranca e djeshme dhe opozita e sotme. Këto i keni të shkruara në raport.

Me këtë gjë dua të them se të gjitha shqetësimet janë të përbashkëta dhe nuk mund t'i ndajmë kursesi kur ulemi në këtë tryezë, që janë fatura që duhet t'i paguajë një forcë politike apo një tjetër. Këto janë fatura që i paguan shoqëria shqiptare nëse nuk i adresojmë dhe i zgjidhim ashtu siç duhet me konsensus dhe me qetësi, që më në fund Komisionin e përkohshëm të Reformës Zgjedhore të mos e bëjmë komision të përhershëm, siç e kemi pasur në 25 vjet. Nëse ka një komision të përhershëm, është Komisioni i Reformës Zgjedhore, që kemi 25 vjet që po e ngremë.

Kështu, duke shprehur vullnetin e qartë të Partisë Socialiste në lidhje me adresimin e të gjitha problemeve që lidhen me zgjedhjet, ne pranuar, pa asnjë mëdyshje zgjerimin e objektivit të këtij komisioni, ku, si asnjëherë tjetër nuk do të kufizohemi vetëm te raporti i OSBE-ODIHR-it. Ne do të marrim parasysh të gjitha shqetësimet që vijnë edhe nga faktorët e tjerë politikë në Shqipëri, edhe nga vëzhgues vendorë, nga shoqëritë civile vendore, që kanë lidhje kryesisht me administrimin e zgjedhjeve, por, sigurisht, edhe me sistemet zgjedhore që ne do të duam të aplikojmë në Shqipëri në një moment të caktuar të historisë politike. Me këtë dua të them se Partia Socialiste ulet në këtë tryezë absolutisht pa asnjë paragjykim. Ne nuk kemi asnjë paragjykim dhe nuk kemi asnjë parakusht të panegociueshëm.

Pa diskutim që edhe çështjen e aplikimit të teknologjisë në administrimin e zgjedhjeve do të duhet ta zgjidhim, ta diskutojmë dhe të gjejmë mënyra që i përshtaten realitetit shqiptar, zhvillimit të shoqërisë shqiptare, teknologjisë e kështu me radhë. Nëse kjo gjë është e mundur dhe nëse na çon në një administrim më korrekt të procesit zgjedhor, pa diskutim që duhet ta aplikojmë, por gjithmonë duke i bërë një diagnozë çdo problemi që do të ngremë dhe që do t'ua lemë ekspertëve. Për fat të mirë, ne kemi përkrahjen e të gjithë partnerëve të Shqipërisë në këtë proces në lidhje me ofrimin e ekspertizës së duhur që do të na duhet për çështje të caktuara, që lidhen me administrimin e zgjedhjeve dhe, pasi të dëgjojmë ekspertët, do të shikojmë praktikën më të mirë. Ne do të provojmë nivelin e suksesit në realitetin shqiptar dhe, pa diskutim, që do të aplikojmë çdo gjë që është në të mirë të procesit zgjedhor.

Kështu që në këtë tryezë do t'ju ftoja që të fillonim diskutimet duke mos u nisur nga paragjykimet apo nga parakushtet që lidhen me një proces apo me një tjetër, me një adresim apo me një tjetër. Sigurisht, primare mbeten ato që tha edhe kolegu im i opozitës, që lidhen me rekomandimet e OSBE-ODIHR-it, sepse janë detyrime që shteti shqiptar ka ndaj organizatave ku është anëtar. Ne e kemi zgjeruar objektin e këtij komisioni dhe do të kemi durimin deri në fund, si dhe do të jemi sa më shterues që të diskutojmë dhe të diagnostikojmë problemet që lidhen qoftë me sistemin politik, qoftë me administrimin e zgjedhjeve.

Kështu, i nderuar Kryetar, edhe unë uroj që këtë radhë të kemi një produkt sa më konsensual dhe që t'i shërbejë vërtet përmirësimit të procesit zgjedhor në Shqipëri, në mënyrë që të kemi sa më pak rekomandime apo gjetje. Në çdo vend të qytetëruar demokratik dhe kudo në botë ka gjetje në lidhje me proceset zgjedhore, sepse ato nuk shpëtojnë asnjëherë, por, të paktën, gjërat e mëdha t'i zgjidhim njëherë e mirë në këtë komision. Ne kemi fatin, sepse kemi kohën e mjaftueshme besoj se ekspertizën do ta kemi të plotë, kështu që asgjë nuk na pengon, përveç vullnetit tonë politik, që të ecim para në këtë proces.

Faleminderit të gjithëve!

**Gramoz Ruçi** – Faleminderit!

Së pari, dua të them se kjo është mbledhja e parë e këtij komisioni, është thjesht për konstituim. Ajo që unë do të kërkoja në këtë mbledhje të parë është që të mos humbasim kohë, por të fillojmë menjëherë nga puna. Pra, sa më shpejt të fillojmë, duke filluar që nga java që vjen, me qëllim që ju të ndërtoni axhendën tuaj, të evidentoni problemet, shqetësimet, jo vetëm të tri raporteve të OSBE-ODIHR-it, por edhe shqetësimet që kanë institucionet zgjedhore në Shqipëri, si dhe shqetësimet që kanë partitë politike, që janë të interesuara drejtpërdrejt për vlerësimin e Kodit Elektorale.

Ajo që doja të kërkoja është: sa më shumë punë në këtë komision dhe sa më pak (këtë do t'ju kërkoja nominalisht) politikë. Unë e kuptoj të gjithë spektrin politik, për këdo që është pjesëtarë i këtij komisioni, por keni vende të tjera për të trajtuar dhe për të zhvilluar debat politik. Unë do t'ju kërkoja që në këtë komision të predominonte shqetësimi respektiv që kanë raportet përkatëse dhe të mos kthehet në debate që janë apo nuk janë zgjedhjet legjitime, sepse nuk është detyra e këtij komisioni të përcaktojë se si kanë qenë zgjedhjet. Këtë gjë e kanë përcaktuar institucionet e këtij vendi, e kanë përcaktuar gjykatat e këtij vendi, ku janë zgjedhjet e para që nuk ka pasur asnjë ankesë në gjykatë, si dhe i ka përcaktuar me pozitivitet, me vërejtje apo me sugjerime edhe OSBE-ODIHR-i në raportet përkatëse.

Prandaj, do t'ju kërkoja, sinqerisht, mirëkuptim, bashkëpunim dhe produktivitet të veprimtarisë së këtij komisioni, me qëllim që afatet që keni përcaktuar vetë ju, me vullnet politik, sepse vërtet është hapur që në fillim të sesionit, por në 6-mujorin e parë të sesionit që vjen, sigurisht, ju duhet të synoni të keni produktin e kësaj çështjeje, në qoftë se vërtet do të punoni si dhe sa duhet me merak, me këtë preokupim, në mënyrë që institucioneve zgjedhore më pas t'u lemë kohën e duhur që të përgatiten qoftë për zgjedhjet vendore, qoftë për zgjedhjet politike.

Prandaj, edhe një herë, dua t'ju uroj suksese! Dua t'ju uroj suksese edhe të pranishmëve, ambasadorit të OSBE-ODIHR-it, përfaqësuesve të Këshillit të Europës dhe BE-së! Sigurisht, asistenca e tyre do të jetë e pakursyer me ekspertët përkatës, për t'u ardhur në ndihmë punës dhe veprimtarisë së këtij komisioni. Sigurisht, për çështje që ju nuk do të dakordësoheni, do të jetë prania e tyre dhe institucioneve të tjera, siç e kemi vendosur edhe në vendimin e Kuvendit, që të shprehen edhe për opsione të ndryshme që mund të kemi në punën dhe veprimtarinë e këtij komisioni.

Këto kisha në këtë mbledhje të parë.

Faleminderit!

**Oerd Bylykbashi** – Në fakt, për shkak të traditës, e inicioni ju këtë mbledhje, por nga ky moment kjo mbledhje kalon në dorën e bashkëkryetarëve.

Faleminderit që e nisët këtë mbledhje!

Jam i sigurt se e njëjta gjë është edhe nga krahu tjetër për një ekspertizë më të mirë nga OSBE-ODIHR-i, KE-ja, BE-ja dhe Komisioni i Venecias, në mënyrë të vazhdueshme në proces. Ky është komisioni më politik i mundshëm i ngritur nga ky parlament, për shkak se problematika është tërësisht politike dhe nuk është aspak teknike.



Zgjedhjet janë themeli i demokracisë dhe kur zgjedhjet bllokohen me mekanizmin e blerjes së votës apo presionit kriminal, më politikë se kaq nuk mund të ketë. Vullnet apo jo, mbetet për t'u treguar, por unë besoj se këtu është vendi që edhe kolegët e tjerë, që përfaqësojnë forcat politike, përtej nesh, kanë të drejtë të thonë diçka dhe të na japin vizionin e tyre. Ky është komision inkluziv dhe për rrjedhojë duhet të kenë të drejtë që të flasin.

**Gramoz Ruçi** – Ju lutem, lëreni tani këtë gjë!

**Oerd Bylykbashi** - Zoti Kryetar!

E drejtojmë ne tani mbledhjen.

**Gramoz Ruçi** – Mbledhjen këtu e drejtoj unë!

**Oerd Bylykbashi** - Zoti Kryetar, kjo është mbledhja Komisionit të Reformës Zgjedhore, dhe ju nuk jeni asnjë zë në kapitullin e këtij komisioni!

**Gramoz Ruçi** – Faleminderit, zoti Ambasador dhe zotërinj përfaqësues të Bashkimit Europian!

**Luan Rama** - Zoti Kryetar, me leje!

Ne nuk kemi ardhur këtu që ta fillojmë mbledhjen dhe ta mbyllim!

Atëherë, arroganca dhe mendjemadhësia nuk është argument për të qenë të bindur se vullneti i saposhprehur nga Kryetari i Kuvendit është real.

Ajo që dua të them...

## **MBYLLET MBLEDHJA**